



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE TË LËNA NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2024, DREJTORIA
E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2024
(GJASHTË MUJORI I PARË)”**

“DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT”

Tiranë, korrik 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE	3
II.	HYRJA	4
1.	Objekti	4
2.	Qëllimi	4
3.	Metodologjia	4
4.	Konkluzioni	4
III.	OPINIONI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE	5
IV.	ZBATIMI I REKOMANDIMEVE	5-20

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtroi auditimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH), mbi “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2024” me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit” të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1139/5 prot., datë 03.06.2024, miratuar me Vendimin nr. 1139/4 prot., datë 31.05.2024, të Kryetarit të KLSH-së, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2024, hartimin e programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
 - a. vendimet (urdhrat) për zbatimin e masave organizative;
 - b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
 - c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të fondeve;
 - ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I.1. Respektimi i afatit ligjor 20 ditor, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

- DPPSH, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, nuk ka respektuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në zbatim me nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I.2. Respektimi i afatit ligjor 6 mujor, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

- DPPSH, nuk ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I.3. Rekomandimet e KLSH

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse nr. 1139/5 prot., datë 03.06.2024, janë lënë **1** masë propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi dhe **19** masa organizative gjithsej.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Nga **1** masë propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, **1** masë nuk është zbatuar;
- Nga **19** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **1** masë është zbatuar plotësisht, **2** masa janë zbatuar pjesërisht, **8** masa janë në proces dhe **8** masa nuk janë zbatuar.

I.4. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

- DPPSH, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ka pranuar rekomandimet dhe ka angazhuar strukturat përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve nga DPPSH, është si më poshtë:

Nr	Lloji i rekomandimit	Të rekomanduara nga KLSH	Të pranuar nga DPPSH
1	Masë propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi	1	1
2	Masa organizative	19	19
	Gjithsej	20	20

I.5. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga DPPSH

Në mënyrë të përmblëdhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit			
			Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces	Zbatuar pjesërisht
1	Masë propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi	1	-	1	-	-
2	Organizative	19	1	8	8	2
	Gjithsej	20	1	9	8	2

II. HYRJE

Auditimi u krye në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 366/3, datë 25.03.2025, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetëror të KLSH, i përbërë nga:

- A.K, përgjegjëse grupi
- K.S, anëtare
- A.A, anëtar
- B.A, anëtar

II.1. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën e KLSH-së, nr. 1139/5 prot., datë 03.06.2024, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

II.2. QËLLIMI AUDITIMIT

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen.

II.4. KONKLUZIONI

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë **1** masë propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi dhe **19** masa organizative.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Nga **1** masë propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi, **1** nuk është zbatuar;
- Nga **19** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **1** është zbatuar plotësisht, **2** masa janë zbatuar pjesërisht, **8** masa janë në proces dhe **8** nuk janë zbatuar.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces	Zbatuar pjesërisht
Masë propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi	1	-	1	-	-
Organizative	19	1	8	8	2
Total	20	1	9	8	2

III. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

- DPPSH, nuk ka respektuar afatin 20 - ditore të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.
- DPPSH, nuk ka respektuar afatin 6 - mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.
- DPPSH ka pranuar rekomandimet e lëna nga KLSH, ka vepruar dhe marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve.
- Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 5%.

IV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve në DPPSH, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 1139/5 prot., datë 03.06.2024, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për auditimin “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit” në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në drejtim të Kundravajtjeve Rrugore;
- Dokumentacionin shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve, etj.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe manualin “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacioni që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”. Nga auditimi i ushtruar në DPPSH, për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të teknologjisë së informacionit të KLSH, me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit” në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në drejtim të Kundravajtjeve Rrugore, të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 1139/4 prot., datë 31.05.2024, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1139/5 prot., datë 03.06.2024, konstatohet se:

- DPPSH, **nuk ka respektuar** afatin 20 ditore të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.
- DPPSH, **nuk ka respektuar** afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të neni 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Për sa më lart, strukturat përgjegjëse pranë DPPSH, nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor të përcaktuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenin 15 germa “j” dhe nenin 30, pika 2, duke mos përcjellë pranë KLSH planin e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar për auditimin e teknologjisë së informacionit “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit” për përcjelljen brenda afateve kohore progresin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në Raportin Përfundimtar të auditimit nr. 1139/5 prot., datë 03.06.2024, “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit” në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në drejtim të Kundravajtjeve Rrugore, ka rekomanduar 1 (një) masë propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) masa organizative.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se niveli i zbatimit të rekomandimeve nga DPPSH, është si më poshtë:

Nga 19 masa organizative të rekomanduara, është zbatuar 1 prej tyre.
Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procesverbalet e konstatimit të shkeljes, u konstatua se fotografimi nuk është bërë pjesë e formularit të miratuar për kundërvajtjen, miratuar me VKM nr. 42, datë 30.01.2019 “Për disa shtesa në VKM nr. 153, datë 7.4.2000, të Këshillit të Ministrave”.

Fotografimi është prova që vërteton shkeljen e konstatuar. Mungesa e kësaj prove në informacionin që i vihet në dispozicion kundërvajtësit nëpërmjet shërbimeve online në eAlbania, bën që të ketë një numër të lartë ankesash në këtë drejtim.

Nga auditimi u konstatua se njoftimi i shkelësit jo prezent për kundërvajtjen duhet të bëhet dhe me shkresë në adresën e tij bazuar në procedurën nr.1719, datë 20.11.2023. Për të realizuar këtë detyrë, punonjësit e policisë që kanë konstatuar dhe regjistruar shkeljen në sistem, detyrohen t’i njoftojnë me shkresë shkelësit që nuk janë konstatuar prezentë. Në shumë raste, kjo procedurë rezulton e paefektshme për shkak të adresave të gabuara apo të paplota në sistemin e adresave, të dhëna këto që lexohen nga regjistri i adresave në DPGJC.

1.1 Rekomandimi: Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marrë masa për shtimin e fotos së kundërvajtjes për mjetin e konstatuar pa prezencë të shkelësit e cila aktualisht nuk është pjesë e formularit të miratuar për kundërvajtjen, me qëllim minimizimin e ankesave, minimizimin e kohës së trajtimit dhe përgjigjes së tyre, nisur nga fakti që fotografimi i shkeljes është një nga provat që vërteton kundërvajtjen.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: Departamenti për Teknologjinë e Informacionit ka marrë të gjitha masat për të zbatuar detyrimet për aq sa përcaktohet në bazat ligjore në fuqi. Fotografimi i shkeljes administrative realizohet nga radarët. Në lidhje me propozime të reja për ndryshime të mundshme, në rastin konkret detyrimi për përcjelljen e shkeljes së kryer shoqëruar me fotografi që në momentin e parë, është vendimmarrje jashtë fushës së veprimtarisë së DTI. (Kërkohen Ndryshime në Kodin Rrugor).

Komenti i grupit të auditimit: DPPSH nuk ka marrë masat e nevojshme për të propozuar ndryshimin ligjor mbi shtimin e fotos së kundërvajtjes për mjetin e konstatuar pa prezencë të shkelësit. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Në strukturën e miratuar për Departamentin e Teknologjisë së Informacionit nga një numër total prej 102 punonjësish aktualisht janë 32 pozicione vakante. Strukturat me më shumë vakanca janë Drejtorja e Sistemeve, Qendra Operative e Sigurisë dhe Drejtorja e Programimit dhe Bazave të të Dhënave.

- Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk ka zhvilluar burimet njerëzore të Auditit të Brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit. Audituesit e strukturës së Auditit të Brendshëm kanë zhvilluar auditime në drejtim të teknologjisë së informacionit por me objektiv të kufizuar për arsye të mungesës në strukturë të specialistëve në fushën e teknologjisë së informacionit. Specialistët e fushës për auditimet që ata kanë zhvilluar i kanë marrë përkohësisht nga struktura e teknologjisë së informacionit në DPPSH duke u siguruar që mos të jenë në konflikt me procesin që është objekt auditimi.

1.1 Rekomandimi: Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në strukturën e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, si dhe

plotësimin e strukturës së Auditit të Brendshëm me punonjës të fushës së Teknologjisë së Informacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për Departamentin për Teknologjinë e Informacionit për periudhën 2024-2025 ka zhvilluar disa procese rekrutimi sipas nevojave dhe vendeve vakante. Nga 32 vende vakante të pasqyruara në raport, aktualisht rezultojnë vetëm 9 vende vakante punonjës administrativ dhe 4 vende vakante Nëpunës Civil.

Komenti i grupit të auditimit: Mbi rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit DPPSH ka marrë masa për plotësimin me punonjës të strukturës së Departamentit të Teknologjisë së Informacionit pjesërisht pasi rezultoi se ka ende vende vakante për këtë strukturë. Gjithashtu, grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion mbi plotësimin e strukturës së Auditit të Brendshëm me punonjës të fushës së Teknologjisë së Informacionit.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- Për sistemin eGjoha nuk është hartuar dhe dokumentuar Strategjia e Backup e dedikuar dhe Strategjia e Rikuperimit e dedikuar me elementët që duhet të përfshihen sipas manualit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

- Nuk dokumentohet procesi i hartimit të planit të testimeve, i realizimit të testimeve dhe i rezultateve të dalta nga testimet e kryera të backup-it të të dhënave të sistemit të gjobave elektronike, si dhe ruajtja e kopjes rezervë në një tjetër ambient.

2.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e Strategjisë së Backup të dedikuar dhe Strategjisë së Rikuperimit të dedikuar. Të dokumentohet procesi i hartimit të planit, realizimit dhe rezultateve të dalta nga testimet e kryera të backup-it të të dhënave të sistemit të gjobave elektronike.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Testimet për Procesin e Backup dhe strategjisë së rikuperimit janë kryer nga operatori i cili ka kryer zhvillimet për sistemin egjoha. Me implementimin e sistemit, procesi Backup kryhet automatikisht në Backup Server dhe në Tape sipas përcaktimeve të pasqyruara në kontratën me operatorin që ka kryer zhvillimet. Prosesi i Rikuperimit të të dhënave kryhet normalisht duke rikthyer makinat virtuale mbi të cilat është ndërtuar sistemi.

Komenti i grupit të auditimit: DPPSH nuk ka marrë masa për hartimin dhe dokumentimin e Strategjisë së Backup të dedikuar dhe Strategjisë së Rikuperimit të dedikuar. Grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion mbi hartimin e planit, realizimit dhe rezultateve të dalta nga testimet e kryera të backup-it të të dhënave të sistemit të gjobave elektronike.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit nuk janë identifikuar dhe dokumentuar risqe për sistemin e kundravajtjeve rrugore eGjoha, me qëllim identifikimin, ndjekjen dhe adresimin e përgjegjësive në drejtim të sigurisë së informacionit.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/ Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, të marrë masa për identifikimin, vlerësimin, ndjekjen dhe adresimin tek personat përgjegjës për risqet në drejtim të sigurisë së informacionit mbi sistemin e menaxhimit elektronik të kundravajtjeve Rrugore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Supozimet dhe risqet për sistemin Egjoba janë përcaktuar në pikën 3 të kontratës me operatorin (Nr. Prot 20 datë 16.08.2022).

Komenti i grupit të auditimit: Mbi këtë rekomandim nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë nga DPPSH/Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit pasi rekomandimi është lënë për identifikimin, vlerësimin, ndjekjen dhe adresimin tek personat përgjegjës për risqet në drejtim të sigurisë së informacionit mbi sistemin e menaxhimit elektronik të kundravajtjeve Rrugore i cili duhet të realizohet nga vetë ju dhe jo çfarë është përcaktuar në kontratën me Operatorin Ekonomik.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

- DTI nuk ka dokumentuar dhe miratuar ndryshimet që janë kryer në sistemin eGjoba gjatë periudhës së audituar. Megjithëse procesi i punës ka vijuar, DTI nuk rezulton të ketë dokumentuar, vlerësuar, prioritarizuar, testuar dhe rishikuar këto ndryshime nga ana e saj. Nuk ka asnjë dokument gjurmueshmërie për ndryshimet e ndodhura ashtu si është e përshkruar edhe në procedurën e ndryshimit.

- Në lidhje me sistemin eGjoba, nuk zhvillohet dokumentimi dhe monitorimi, për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin. Për periudhën nën auditim problemet dhe incidentet janë menaxhuar mbi bazë ngjarjesh dhe nuk ka një dokumentim të raportimit dhe zgjidhjes së tyre.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për hartimin e procedurave të administrimit të ndryshimeve që kryhen në lidhje me teknologjinë e informacionit, duke patur në konsideratë dhe ndryshimet emergjente. Gjithashtu të marrë masa për dokumentimin specifik të çdo ndryshimi duke siguruar gjurmueshmërinë dhe impaktin që kanë sjellë ndryshimet e aplikuar në sistem e rrjedhimisht në të dhëna, si dhe të bëhet dokumentimi dhe monitorimi i incidenteve dhe problemeve nga DTI.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Sa i përket zhvillimeve të reja në sistemin egjoba, DTI ka mbajtur korrespondence përmes postës elektronike (email) me strukturat përfituese të sistemit. Për secilën nevojë të shfaqur për përmirësim janë evidentuar kërkesat e strukturave të mësipërme dhe pas analizimit të tyre janë përcjellë operatorit për kryerjen e zhvillimeve. Këto kërkesa janë paraqitur në mbledhjet periodike të zhvilluara me operatorin ekonomik për të cilat janë dokumentuar minutat e takimit së bashku me çështjet e diskutuara.

Komenti i grupit të auditimit: Për këtë rekomandim rezulton se, nga ana e DPPSH nuk janë marrë masat për hartimin e procedurave të administrimit të ndryshimeve, si dhe nuk është bërë dokumentimi dhe monitorimi i incidenteve nga DTI. Grupit të auditimit i janë vendosur në dispozicion komunikime me email mbi takimet që janë zhvilluar për disa nga zhvillimet e reja në sistemin eGjoba.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar pjesërisht**.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në sistemin eGjoba janë në total 4830 përdorues Aktiv dhe Jo Aktiv nga të cilët:

- Vetëm 117 prej tyre janë jo aktiv nga ku konstatohet se ka përdorues të cilët edhe pse kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës për arsye të ndryshme kanë ende statusin aktiv në sistem;

- 308 përdorues e kanë fushën START_DATA të pa plotësuar;

- Nga 117 përdorues jo aktiv në sistem vetëm 2 prej tyre e kanë fushën END_DATE të plotësuar;

- 74 përdorues janë me username emër.mbiemërnumër dhe jo sipas formatit standard emër.mbiemër;

- Fushat që përmbajnë userat e sistemit eGjoba nuk janë të detyrueshme për t'u plotësuar për çdo përdorues. Nga verifikimi rezulton se 169 përdorues nuk kanë të plotësuar të gjitha fushat si 'officer_id', 'forename', 'surname', 'function' etj, por kanë të plotësuar vetëm fushat 'username', 'active' (nga të cilët 6 prej tyre rezultojnë jo aktivë), 'start_date' (nga të cilët 13 janë fusha boshe), 'end_date' (vetëm një username ka datë mbyllje), si dhe është përcaktuar 'rol' për secilin username;
- Nga verifikimi i përdoruesve të sistemit me ata të larguar në periudhën e audituar rezulton se ka përdorues të cilët nuk ekzistojnë fare në sistem;
- Ka përdorues të cilët janë jo aktiv dhe nuk kanë një datë mbyllje;
- Nga verifikimi rezulton se ka përdorues të cilët janë me emër dhe mbiemër përsëritës dhe janë shënuar si username në formatin emër.mbiemërnumër;
- Hapja, mbyllja dhe ndryshimet e përdoruesve mbeten të pa monitoruara duke rritur riskun krijimit të përdoruesve të paautorizuar, e për pasojë humbjen e konfidencialitetit të të dhënave apo keqpërdorimin e tyre;
- Përdorues me username 'bashkia.shkoder' që nuk identifikohen se kujt i përket, pra nuk lidhet me një përdorues të përvetshëm në mënyrë që të mbikëqyret se cili person e përdor;
- Nuk ka një rregullore apo dokument tjetër shkresor ku të përcaktohet qartë lidhja përdorues-rol, duke sjell risk potencial në përcaktimin e të drejtave mbi përdorimin e sistemit, si dhe akumulimin e privilegjeve;
- Nga verifikimi rezulton se fusha Function nuk është e njëjta për funksione të njëjta që kryhen në sistemin eGjoba.

5.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të marrin masa për unifikimin e të dhënave për përdoruesit e Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Gjjobave, të plotësoj të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e tyre në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e krijimit me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara, të marrë masa për rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesit. Gjithashtu të marrë masa për analizimin e situatës aktuale të evidentuar nga grupi i auditimit në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave mbi përdoruesit e sistemit eGjoba.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Sistemi egjoba ndërvepron me sistemin RMIS. Procesi i unifikimit të dhënave të përdoruesve është planifikuar të kryhet me zhvillimet e rejtat të sistemit RMIS. Ky sistem i cili i përket vitit 2001 nuk pasqyron ndryshimet e strukturës dhe të dhënave të punonjësve në sistemet e tjera përfshirë egjoba.

- Statusi aktiv joaktiv përcaktohet nga komunikimi RMIS-EGJOBA.
- Fusha Start Date – End Date paplotësuar për 308 punonjës është analizuar dhe ka ardhur si problematikë e periudhës viti 2017. Aktualisht me ngritjen e aplikacionit sistemi nuk ruan veprimin për krijimin e përdoruesve nëse fusha është e paplotësuar.
- Fushat e paplotësuara për disa përdorues si psh. 'officer_id', 'forename', 'surname', 'function' vijnë si rezultat i mungesës së të dhënave për përdorues nga struktura të tjera si BKH, Polici Bashkiake etj.
- përdoruesit të cilët janë larguar në periudhën e auditimit dhe nuk rezultojnë në sistem lidhet me kërkesën e strukturave përgjegjëse për pajisjen me akseset e nevojshme në momentin e emërimit të punonjësit.
- përdoruesit jo aktiv të cilët nuk kanë datë mbyllje ka ardhur si rezultat i veprimit i cili nuk e shfaq të detyrueshme përcaktimin e datës
- përdorues të cilët janë me emër dhe mbiemër përsëritës dhe janë shënuar si username në formatin emër.mbiemërnumër shfaqen për arsye se kemi disa përdorues me të njëjtin emër.
- Hapja, mbyllja dhe ndryshimet e përdoruesve janë të përcaktuara vetëm për struktura të autorizuara DTI-SMI.

-Përdorues me username ‘bashkia.shkoder’ rezulton joaktiv në sistem

Lidhja përdorues-rol së bashku me të drejtat në sistem përcaktohen sipas funksionit të përdoruesit dhe detyrave funksionale të parashikuara në përshkrimet e punës së punonjësit.

Komenti i grupit të auditimit: Duke qenë se, DPPSH ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe sqaron se procesi i unifikimit të të dhënave të përdoruesve është planifikuar të kryhet me zhvillimet e rejtat të sistemit RMIS.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, nuk është hartuar një rregullore ose dokument mbi parametrizimin e fjalëkalimeve që të përcaktojë përmbajtjen, gjatësinë, mos përsëritjen e të njëjtit fjalëkalim etj. Nuk janë dokumentuar politikat e sigurisë të implementuara për përdoruesit e sistemit, si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për dokumentimin e politikave të sigurisë për përdoruesit e sistemit si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Politikat e sigurisë për fjalëkalimet merren nga domain i Policisë së Shtetit. Ky proces imponon një fjalëkalim të unifikuar platformat në dispozicion të përdoruesit, i cili mund të ndryshohet nga vetë përdoruesi në çdo moment.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi i lënë nga grupi i auditimit konsiston në dokumentimin e politikave të sigurisë për përdoruesit e sistemit si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN”, viti 2023, kriteri i veçantë nr. 2, pika a), “*të paktën 1 specialist të certifikuar për menaxhim projektesh, PRINCE 2 ose ekuivalent*” është i panevojshëm, jo në përputhje me kuadrin ligjor të prokurimit publik, si dhe cenon konkurrencën midis operatorëve ekonomikë. Certifikata për menaxhim projektesh (PRINCE 2 ose ekuivalent) shërben për menaxhimin efektiv të një projekti, duke filluar nga faza e planifikimit, ekzekutimit, raportimit, monitorimit dhe vlerësimit. Mirëmbajtja dhe vendosja e pjesëve për pajisjet e rrjetit LAN nuk është një projekt, por një procedurë e zakonshme prokurimi malli/shërbimi. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, Njësia e Prokurimit, si dhe personat e autorizuar për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriteret kualifikuese të veçanta, të respektojnë legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse në fushën e prokurimit publik duke mos vendosur kriteret e veçanta të panevojshme, për të garantuar një pjesëmarrje të gjerë dhe jo diskriminuese të operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Kërkesë e përcjellë në strukturat përkatëse në Policinë e Shtetit përmes përmbledhjes ekzekutive të hartuar nga Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Nr. 685/8 datë 10.06.2024 mbi rekomandimet e lëna.

Komenti i grupit të auditimit: Grupi i auditimit ka shqyrtuar shkresën me nr. 685/8 prot., datë 10.06.2024 e cila është vendosja në dijeni Drejtorit të Përgjithshëm në DPPSH mbi gjetjet dhe rekomandimet kryesore të lëna nga grupi i auditimit dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN”, viti 2023, u konstatua se kriteret e veçanta nr. 2 dhe 3 mbi kapacitetin teknik nuk janë të argumentuara teknikisht, por vetëm ligjërisht, në kundërshtim kjo me nenin 78, pika 2 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku citohet se: “Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, Njësia e Prokurimit, si dhe Specialisti i fushës të marrin masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të kryhet argumentimi ligjor dhe teknik i të gjitha kriterëve të vendosura, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese ndaj operatorëve ekonomikë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Kërkesë e përcjellë në strukturat përkatëse në Policinë e Shtetit përmes përmbledhjes ekzekutive të hartuar nga Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Nr.685/8 datë 10.06.2024 mbi rekomandimet e lëna.

Komenti i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, DPPSH ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe është marrë angazhimi për ta përmbushur atë. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 3 procedurave të prokurimit me objekt, përkatësisht, “Instalim kabineti Outdoor”, viti 2023; “Shërbim, mirëmbajtje, pjesë këmbimi kondicionerë për sallë serverësh dhe sallat e IT-së”, viti 2022; “Mirëmbajtje dhe pjesë këmbimi për pajisjet e rrjetit LAN”, viti 2023, u konstatua se Plani i zbatimit të kontratës nuk është lidhur brenda 7 ditëve nga data e lidhjes së kontratës sipas përcaktimit të nenit 124, pika 3 e LPP, si dhe nuk është njoftuar APP brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i tij, në zbatim të nenit 125, pika 1 e LPP, si dhe nenit 107, pika 4 e VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, si dhe personat e autorizuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës, të marrin masa që për procedurat e prokurimit publik që do të zhvillohen në vijimësi të mbajnë parasysh të gjitha përcaktimet e dispozitave ligjore proceduriale përkatëse, duke mbikëqyrur rigorozisht zbatimin e kontratës për ofrimin e një malli apo shërbimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Kërkesë e përcjellë në strukturat përkatëse në Policinë e Shtetit përmes përmbledhjes ekzekutive të hartuar nga Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Nr.685/8 datë 10.06.2024 mbi rekomandimet e lëna.

Komenti i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, DPPSH ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe është marrë angazhimi për ta përmbushur atë. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentet e vëna në dispozicion për ndjekjen e kontratës nr.3921, datë 07.08.2018, për periudhën 2018-2022, si dhe kontratën nr.20, datë 16.08.2022, për periudhën 2022-2023, u konstatua se DPPSH nuk është përfaqësuar me asnjë punonjës të Drejtorisë së Policisë Rrugore në cilësinë e përfituesit të shërbimit, por është përfaqësuar në ndjekjen e kontratës me një punonjës nga struktura e Departamentit të

Teknologjisë së Informacionit. Asnjë nga specialistët e caktuar si ndjekës kontrate prej dy institucioneve AKSHI dhe DPPSH nuk është njohës i proceseve operacionale në Drejtorinë e Policisë Rrugore, që realizohen nëpërmjet sistemit eGjoba.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues i shërbimeve të informatizuara në sistemin eGjoba, të përcaktojë si ndjekës të kontratës aktuale nr. 20, datë 16.08.2022 për këtë sistem, specialist të Drejtorisë së Policisë Rrugore që njohin proceset e punës dhe monitorojnë proceset e informatizuara në nivel qendror.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: Ndjekësi i kontratës aktuale nr. 20, datë 16.08.2022 për sistemin Egjoba, ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me përfaqësuesit e strukturës përfituese. Për të gjitha nevojat dhe problematikat e paraqitura është marrë vendim në koordinim me strukturat e Policisë Rrugore. Në disa raste nevojat e paraqitura kërkojnë njohuri teknike në fushën e IT për interpretimin e tyre.

Komenti i grupit të auditimit: Nga ana e DPPSH nuk është marrë asnjë masë në zbatim të këtij rekomandimi për të caktuar si ndjekës të kontratës specialist të Drejtorisë së Policisë Rrugore që njohin proceset e punës dhe monitorojnë proceset e informatizuara në nivel qendror.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga departamenti i IT, për zbatimin e kontratës nr.3921, datë 07.08.2018, me Autoritet Kontraktor AKSHI-n dhe Autoritet Përfitues i shërbimit DPPSH, u konstatua se dokumentet përgjatë periudhës së mirëmbajtjes në disa raste mungojnë e në disa raste janë nënshkruar në grup për 2 apo 3 muaj shërbim mirëmbajtje njëkohësisht, çfarë tregon për një vijimësi formale në ndjekjen e zbatimit të kontratës. Nuk janë raportuar problematika në lidhje me sistemin eGjoba duke lënë të kuptohet se nuk ka pasur asnjë problematikë, megjithëse vetë agjentët e policisë u shprehën se deri në fund të vitit 2023 sistemi ka shfaqur probleme të vazhdueshme.

Nga auditimi mbi raportet e kërkuara sipas specifikimeve teknike në kontratën nr.3921, datë 07.08.2018, me Autoritet Kontraktor AKSHI-n dhe Autoritet Përfitues i shërbimit DPPSH, për filtrimin e të dhënave të populluara elektronikisht, u konstatua se aktualisht nuk janë ndërtuar raporte sipas llojit të shkeljes dhe sipas zonave. Kjo kërkesë e specifikimeve teknike rezulton e paplotësuar aktualisht nga OE.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues i shërbimeve të informatizuara në sistemin eGjoba, në mungesë të punonjësve që kanë vepruar si ndjekës të kontratave të sistemit eGjoba, të ngrejë një grup specialistësh me qëllim verifikimin e çështjeve që nuk janë realizuar në kontratën e parë nga OE, i cili është aktualisht i kontraktuar dhe për kontratën aktuale. Mangësitë të përcillen tek AKSHI si Autoritet Kontraktues për sistemin eGjoba dhe përmirësimin e tij.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: Ndjekësi i kontratës aktuale nr. 20, datë 16.08.2022 për sistemin eGjoba, ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me përfaqësuesit e strukturës përfituese. Për të gjitha nevojat dhe problematikat e paraqitura për përmirësim janë përcjell AKSHI-të dhe Operatorit Ekonomik.

Komenti i grupit të auditimit: Në zbatim të rekomandimit të lënë grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion i ngritjes së një grupi specialistësh me qëllim verifikimin e çështjeve që nuk janë realizuar në kontratën e parë nga OE. Për sa i përket nevojave dhe problematikave të paraqitura për përmirësim që i janë përcjellë AKSHI-të dhe Operatorit Ekonomik nga ana e ndjekësit të kontratës grupit nuk i është vendosur dokumentacion në dispozicion me qëllim shqyrtimin e tyre.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës me nr.20, datë 16.08.2022 me objekt “Përmirësimi i sistemit eGjoba, integrimi me pajisjet radar dhe plotësimi me tableta për Policinë e Shtetit”, u konstatua se nuk janë plotësuar kërkesat e specifikimeve teknike të parashikuara mbi raportimin, që janë:

- Raporti fillestar i prodhuar brenda 5 ditësh nga fillimi i implementimit;
- Draft Raporti Përfundimtar prej maksimumi 20 faqesh i prodhuar deri në 1 muaj para përfundimit të kontratës;
- Raporti final me të njëjtat specifika si Draft Raporti përfundimtar i prodhuar brenda 5 ditësh pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar.

*Nga auditimi mbi funksionet shitesë të parashikuara në kontratën me nr.20, datë 16.08.2022, u konstatua se disa nga kërkesat e specifikimeve teknike **nuk janë realizuar**, të cilat janë:*

- Integrimi me 6 pajisjet radar fiks dhe shfaqja e eventeve të këtyre pajisjeve, nuk është realizuar në sistemin eGjoba. Të dhënat e shpejtësisë, targës dhe fotografimi i tij nuk janë ekspozuar në sistemin eGjoba në mënyrë automatike sikurse është kërkuar në rubrikën “Integrimi në eGjoba i 6 radarëve fiks ekzistues”. Moduli i ndërtuar për regjistrimin e gjobave nga Salla e Monitorimit, nuk konsiderohet integrimi i pajisjeve, por është një ndërfaqe e zhvilluar për regjistrimin e kundërvajtjeve nga kjo strukturë operationale;
- Integrimi me Policinë Bashkiake nuk është bërë nëpërmjet një API sikurse është kërkuar në specifikimet teknike, por me akses të drejtpërdrejtë në sistem;
- Nuk është ndërtuar ndërveprim me eGjoba i sistemit të radarit të montuar në mjedin inteligjent, sikurse është kërkuar në specifikimet teknike;
- Në rastin e targave të huaja nuk është bërë akoma i mundur ekspozimi i informacionit të kundërvajtjeve për sistemin TIMS që gjoba të paguhet në kufi kur mjedi del. Kjo kërkesë është parashikuar në specifikimet teknike në rubrikën “Integrimi i pajisjeve të matjes së shpejtësisë dhe verifikimit”;
- Nuk është ndërtuar ndërveprim për marrjen, ruajtjen dhe shfaqjen e informacioneve shitesë për automjetin nga DPSHTRR si ngjyra, fuqia motorike, viti i prodhimit të automjetit;
- Në rubrikën “Raporte” për të dy kontratat janë parashikuar raporte mbi të njëjtat kritere, pavarësisht që kontratat e nënshkruara për sistemin eGjoba janë zhvilluar me 4 vite diferencë. Nuk rezultojnë të jenë ndërtuar raporte bazuar në llojin e shkeljes apo sipas vendndodhjes që konsiderohen “Zona” sipas Policisë Rrugore, ndërsa në specifikimet teknike është kërkuar në rubrikën “Raporte”. Kjo kërkesë nuk është përmbushur që në kontratën e parë nr. 3921, datë 07.08.2018 dhe ka vijuar të mos jetë plotësuar me kontratën nr. 20, datë 16.08.2022.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues i shërbimeve të informatizuara në sistemin eGjoba, të përcjellë tek AKSHI si Autoritet Kontraktues, mangësitë në zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit eGjoba në zbatim të kontratës nr.20, datë 16.08.2022, të cilat jo vetëm nuk janë realizuar, por kanë penguar veprimet operationale të nevojshme për Drejtorinë e Policisë Rrugore Drejtorisë së Policisë Rrugore.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: Me shkresën protokolluar nga DPPSH me nr. 7633 Prot., datë 09.08.2024 (DPPSH për dijeni) është përcjellë informacioni për plotësimin e mangësive të konstatuara, e cila i është drejtuar KLSH dhe AKSHI.

Komenti i grupit të auditimit: Në zbatim të rekomandimit të lënë, grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion në lidhje me komunikimet për përcjelljen tek AKSHI si Autoritet Kontraktor të mangësive në zbatim të kontratës për sistemin eGjoba. Për sa i përket informacionit të dërguar nga Operatori Ekonomik për plotësimin e mangësive të konstatuara, e cila i është drejtuar KLSH dhe AKSHI me shkresën nr. 7633 prot., datë

09.08.2024 protokolluar në DPPSH rezulton se janë observacione nga OE mbi Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion për sistemin eGjoba, u konstatua se nuk janë përcaktuar rregullat mbi administrimin e të dhënave dhe nivelet e aksesimit për të gjithë palët që kanë akses mbi to në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, ku DPPSH është krijues, zotërues dhe administrues, ndërsa AKSHI është ofrues i shërbimit të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe sistemit informatik të cilat aktualisht i ka kontraktuar tek Operatori Ekonomik.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si institucion krijues dhe administrues i të dhënave që ruhen në sistemin eGjoba, të marrë masa për hartimin e procedurave, organizimin dhe funksionimin e brendshëm si dhe përcaktimin e niveleve të aksesimit në këto të dhëna, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: Niveli i aksesit sipas roleve është përcaktuar nga Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave (DMIMDH) bazuar në detyrat funksionale të përdoruesit dhe bazave ligjore ne fuqi.

Komenti i grupit të auditimit: Grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion mbi zbatimin e këtij rekomandimi.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi dy procesverbalet e gjeneruara të sistemit eGjoba ku njëri shkruhet në tablet, ndërsa tjetri në ndërfaqen e përdoruesit operacional, u konstatuan disa mospërputhje për të njëjtat fusha që janë renditur si më poshtë:

- Nr. Serial quhet nëse regjistrohet në tablet dhe Seria NR quhet e njëjta fushë nëse gjenerohet nga salla e monitorimit.

- Teksti shpjegues në qelizën referuar sanksionit nuk paraqet të njëjtën përmbajtje në të dy procesverbalet.

- Personi që ka kryer kundërvajtjen nëse gjenerohet nga tableti quhet “kundërvajtësi”, ndërsa nga moduli i sallës së monitorimit quhet “Shkelësi”.

- Format i datës në procesverbalin e gjeneruar nga tableti në formën dd-mm-yyyy ndryshon me formatin e datës të gjeneruar nga moduli ku regjistrohen të dhënat e pajisjeve inteligjente në formën dd.mm.yyyy.

- Të dhënat e mjetit në procesverbalin e gjeneruar nga tableti janë Marka, Targa, Tipi dhe Kapaciteti. Ndërsa të dhënat e gjeneruara nga moduli i sallës operacionale janë: Tipi, Targa dhe Kapaciteti.

- Në kategorinë “Shkelja” përcaktohen nenet e shkeljes, por emërtimet e tyre nuk paraqiten në mënyrë respektive sipas radhës së vendosur të neneve, çfarë krijon konfuzion në leximin e shkeljeve dhe referencat ligjore.

- Në procesverbalin e gjeneruar nga tableti për datën dhe vendin, ruhen të dhëna në fushat “Adresa” dhe “Qyteti”. Ndërsa, në procesverbalin e konstatimit të shkeljes të regjistruar në sistem nëpërmjet modulit të ri të njëjtën fushë ruhen të dhëna në fushat “Rruga” dhe “Vendi”. Nga auditimi mbi ndërfaqen e sistemit “Gjobë nga SM” për plotësimin e e kundravajtjeve, në fushën e përcaktuar si “Deklarata e Agjentit” popullimi i saj është një përshkrim i tipit “text”, në të cilin shënohen data dhe ora kur është gjeneruar fotografimi nga mjetet inteligjente. Si text shënohen gjithashtu të dhënat për nenin, ligjin, aksin rrugor, pikët e zbritura, shpejtësia e fotografuar, si dhe pajisja radar që e ka fotografuar

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me Drejtorinë e Policisë Rrugore të marrin masa për unifikimin e të dhënave të ndryshme të evidentuara në procesverbalet që gjenerohen nga i njëjti sistem, por nga ndërfaqe përdorimi të ndryshme që gjenerohen nga agjentët nëpërmjet pajisjeve tablet dhe ndërfaqja në përdorim të zyrës operacionale.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: Aktualisht rezulton se unifikimi i të dhënave për procesverbalet nga pajisje të ndryshme ka përfunduar.

Komenti i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, sqarohet se jo për të gjitha funksionalitetet është bërë unifikimi në sistem.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan disa problematika të ndërveprimit të të dhënave me DPSHTRR, të cilat janë:

- Nuk është ndërtuar ndërveprim ndërmjet sistemit eGjoba dhe DPSHTRR, për periudhën e plotë që drejtuesi rezulton i pajisur me leje drejtimi, me qëllim përlllogaritjen për zbritjen e pikëve në rast të një kundra vajtjeje. E dhëna që lexohet nëpërmjet web-servisit është data e lëshimit të leje drejtimit, ku në rastet kur ajo është e rinovuar, nuk tregon kohën e plotë që drejtuesi është pajisur me leje drejtimi. Agjenti i policisë nuk ka një mënyrë se si të përlllogarisë zbritjen e pikëve mbi një leje drejtimi në rast se diferenca ndërmjet datës së konstatimit me datën e lëshimit të lejes tregon se ai/ajo është një drejtues i ri ndërkohë që leja e drejtimit është e rinovuar. Vetë punonjësit e policisë rrugore në terren u shprehën se kanë marrë vërejtje për vendosjen e masave plotësuese jo të sakta për këtë arsye;

- Pikët e zbritura nga patenta, për një kundravajtje të caktuar nuk pasqyrohen saktë në sistemin eGjoba ndryshe nga portali e_Albania ku situata mbi pikët e zbritura dhe të shtuara duket e saktë. Kjo tregon se ndërveprimi ndërmjet DPSHTRR-së dhe sistemit eGjoba nuk është ndërtuar në mënyrën e duhur;

- Nuk lexohen elektronikisht të dhënat mbi kontrollin teknik. Ky verifikim aktualisht bëhet vetëm në prezencë të drejtuesit duke parë dhe verifikuar dokumentin fizik të lëshuar nga DPSHTRR;

- DPSHTRR dhe DPPSH nuk kanë aktualisht të ndërtuar një bashkëveprim me qëllim vjeljen e gjobave duke lexuar nga sistemi i eGjoba detyrimin e kundërvajtësit përpara kolaudimit.

15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të përcjellë për zgjidhje tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit problematikat që janë evidentuar nga auditimi dhe vijnë si rezultat i mangësisë apo parregullsisë së ndërtuar si ndërveprim ndërmjet bazë së të dhënave të sistemit eGjoba dhe bazës së të dhënave të mjeteve nën administrimin e DPSHTRR-s.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: Operatori ekonomik dhe autoriteti kontraktues janë përgjigjur se mbeten në pritje të vënies në dispozicion të webservise nga DPSHTRR sa i përket leximit elektronik të dhënave mbi kontrollin teknik. ...

Kthimi i përgjigjes Nr.2788/2 datë 28.08.2024 nga autoriteti kontraktor (AKSHI) drejtuar KLSH dhe për dijeni Policisë së Shtetit. Kthimi i përgjigjes Nr. Prot 7633 datë 09.08.2024 drejtuar KLSH dhe për dijeni Policisë së Shtetit.

Komenti i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, DPPSH ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe është marrë angazhimi për ta përmbushur atë.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

16. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren mbi përdorimin e sistemit eGjoba u konstatua se:

- Përveç regjistrimit në sistem, agjentët e policisë rrugore i regjistrojnë kundravajtjet manualisht në një regjistër, ku të dhënat që regjistrohen aty lexohen nga sistemi, ku po të njëjtët punonjës i kanë regjistruar më parë. Ky veprim manual jo vetëm që nuk është efektiv, por rrit fiktivisht ngarkesën e punonjësve;
- Letrën e printerave termikë që e kanë të lidhur me tabletët, agjentët e sigurojnë në mënyrë individuale pasi prej kohësh nuk ka patur gjendje;
- Në disa raste, agjentët shprehën shqetësimin se dhe radiot e komunikimit i sigurojnë po në mënyrë individuale pasi nuk ka patur gjendje. Ky element cenon sigurinë në komunikimin ndërmjet tyre pasi radiot që shiten në treg jo gjithmonë i plotësojnë kriteret e nevojshme për të qenë të sigurta;
- Vetë agjentët shprehen se pajisjet alkoolmatëse, megjithëse janë të kolauduara, nuk japin të dhëna të afërta me sa konstatohet nga ky verifikim.

16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/ Drejtoria e Policisë Rrugore të marrë masa për të shmangur veprime manuale joefektive të agjentëve të policisë rrugore për të dhëna që gjenden të regjistruara në sistemin eGjoba. Gjithashtu, të merren masa për pajisjen e tyre me elementët e nevojshëm si letër printeri, bateri, etj për përdorimin e pajisjeve regjistruese të kundravajtjeve në terren me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes dhe veprimet në sistem.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Për Agjentët e Policisë Rrugore është përcjellë manuali i përdorimit të sistemit si edhe janë dhënë udhëzimet për kryerjen e veprimeve në sistemin eGjoba. Pajisja me letër printeri, radio komunikimi, është përcjellë për marrje të masave nga strukturat përgjegjëse - Departamenti për Shërbimet Mbështetëse.

Komenti i grupit të auditimit: Grupi i auditimit ka shqyrtuar shkresën me nr. 685/8 prot., datë 10.06.2024 e cila është vendosja në dijeni Drejtorit të Përgjithshëm në DPPSH mbi gjetjet dhe rekomandimet kryesore të lëna nga grupi i auditimit dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionalitetet e sistemit eGjoba për kundravajtjet e konstatuara në mjetet me targa të huaja, u konstatua se:

- Nuk hidhen në sistemin gjoba, në mënyrë që këto të dhëna të jenë të vlefshme për t'u ekspozuar në sistemin TIMS për kontrolle në pikat kufitare. Përcjellja me rrugë shkresore për në pikat kufitare, tregon se lidhja ndërmjet sistemit TIMS dhe eGjoba nuk është bërë për njoftime automatike për këto raste të kundravajtjeve nga mjete me targa të huaja, megjithëse të dy sistemet janë në përdorim të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Hartimi shkresor i "Njoftimit në kufi" është joefektiv për sa i takon vjeljes së kundravajtjes për arsye se identifikimi i rasteve dhe komunikimi deri në njësitë kufitare bëhet për më shumë se 24 orë;
- Në sistemin eGjoba nuk është ndërtuar një funksionalitet ku agjenti krahas kundravajtjes, të mund të plotësojë dhe arkëtimin duke e regjistruar rekordin në sistem dhe të gjenerojë një faturë arkëtimi sikurse gjeneron dhe printon një faturë kundravajtje, me qëllim ruajtjen e të dhënave në sistem dhe parandalimin e abuzimit në këto raste.

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues për shërbimet e informatizuara në sistemin eGjoba, të përcjellë tek AKSHI procesin që nuk është realizuar nga OE për mundësimin e regjistrimit të të dhënave të kundravajtjes në sistemin eGjoba në mënyrë që këto të dhëna të jenë të ekspozueshme për sistemin TIMS.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: Lidhja ndërmjet sistemit TIMS dhe eGjopa për njoftime automatike të kundravajtjeve nga mjete me targa të huaja është parashikuar në kontratën aktualë për zhvillimet në sistemin TIMS.

Komenti i grupit të auditimit: Nga shqyrtimi i dokumentacionit, DPPSH ka pranuar rekomandimin e lënë nga grupi i auditimit dhe është marrë angazhimi për ta përmbushur atë. Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

17.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues për shërbimet e informatizuara në sistemin eGjopa, të përcjellë tek AKSHI, nevojën për të regjistruar në sistem arkëtimin e vlerës së kundravajtjes së kryer nga mjete me targa të huaja, si në një proces që aktualisht ka mbetur jashtë informatizimit dhe administrohet manualisht në bllok fizik nga agjenti.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: Nevoja për të regjistruar në sistem arkëtimin e vlerës së kundravajtjes së kryer nga mjete me targa të huaja, nuk është parashikuar në kontratën me nr.20, datë 16.08.2022.

Komenti i grupit të auditimit: Rekomandimi konsiston në përcjelljen nga ana juaj tek AKSHI të nevojës për të regjistruar në sistem arkëtimin e vlerës së kundravajtjes së kryer nga mjete me targa të huaja. Grupit të auditimit nuk i është vendosur në dispozicion asnjë dokumentacion mbi inicimin e zbatimit të këtij rekomandimi.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi raportet e ndryshme të ndërtuara në sistemin eGjopa, u konstatua se nuk janë ndërtuar filtrime të dhënash që të plotësojnë kërkesat e Drejtorisë së Policisë Rrugore, pasi:

- Nuk ka raporte të ndërtuara për filtrime sipas qarkut;
- Nuk ka raporte të ndërtuara për shkeljet me më pak se 5 apo me më shumë se 5, pra të ndryshme nga numri 5. Për numrin e shkeljeve është ndërtuar një raport që ka kushtin që kundravajtjet të jenë aktive në 5 raste;
- Në raportin “*Statistikë sipas neneve*” nuk gjenerohen shkelje sipas neneve, por sipas datave të vendosura si fusha kryesore filtrimi. Të dhënat që nxjerr ky raport nuk eksportohen në excel për analiza të mëtejshme që i nevojiten Drejtorisë së Policisë rrugore bazuar në shkeljet sipas neneve;
- Në excel janë lejuar të eksportohen raporte mbi një person apo një mjet, ndërkohë që analizat që nevojiten të bëhen nga Drejtoria e Policisë Rrugore nuk bazohen në rekorde individuale, por sasiore me të dhëna të plota.

18.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues për shërbimet e informatizuara në sistemin eGjopa, të përcjellë tek AKSHI mangësitë dhe jo efikasitetin e evidentuar gjatë auditimit si dhe nga puna e tyre në vazhdimësi, në raportet që janë ndërtuar në sistemin eGjopa. Mungesa e larmishmërisë së raporteve në përputhje me kërkesat e Drejtorisë së Policisë Rrugore, pengon analiza të mëtejshme për vendimmarrje, vlerësime dhe nevoja të ndryshme që Autoriteti Përfitues ka nevojë.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: Sa i përket procesit për gjenerimin e raporteve të ndryshme kanë përfunduar zhvillimet e nevojshme dhe janë të realizuar sipas kërkesave të strukturës përfituese.

Komenti i grupit të auditimit: DPPSH ka marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi duke bërë zhvillimet e nevojshme sipas rekomandimit të kërkuar.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces	Zbatuar pjesërisht
Masë propozime për ndryshime apo përmirësime në legjislacionin në fuqi	1	-	1	-	-
Organizative	19	1	8	8	2
Total	20	1	9	8	2

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

- DPPSH, nuk ka respektuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve për KLSH
- DPPSH, nuk ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve për KLSH
- DPPSH, ka vepruar dhe ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve.
- Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 5%.

Për sa më sipër, ri kërkojmë që, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë të pazbatuara, në proces zbatimi dhe pjesërisht të zbatuara, brenda vitit 2025.

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, të marrë masa për shtimin e fotos së kundravajtjes për mjetin e konstatuar pa prezencë të shkelësit e cila aktualisht nuk është pjesë e formularit të miratuar për kundërvajtjen, me qëllim minimizimin e ankesave, minimizimin e kohës së trajtimit dhe përgjigjes së tyre, nisur nga fakti që fotografimi i shkeljes është një nga provat që vërteton kundravajtjen.

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për plotësimin e vendeve vakante në strukturën e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, si dhe plotësimin e strukturës së Auditit të Brendshëm me punonjës të fushës së Teknologjisë së Informacionit.

2.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrin masa për hartimin dhe dokumentimin e Strategjisë së Backup të dedikuar dhe Strategjisë së Rikuperimit të dedikuar. Të dokumentohet procesi i hartimit të planit, realizimit dhe rezultateve të dala nga testimet e kryera të backup-it të të dhënave të sistemit të gjobave elektronike.

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/ Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, të marrë masa për identifikimin, vlerësimin, ndjekjen dhe adresimin tek personat përgjegjës për risqet në drejtim të sigurisë së informacionit mbi sistemin e menaxhimit elektronik të kundravajtjeve Rrugore.

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për hartimin e procedurave të administrimit të ndryshimeve që kryhen në lidhje me teknologjinë e informacionit, duke patur në konsideratë dhe ndryshimet emergjente. Gjithashtu të marrë masa për dokumentimin specifik të çdo ndryshimi duke siguruar gjurmueshmërinë dhe impaktin që kanë sjellë ndryshimet e aplikuara në sistem e rrjedhimisht në të dhëna, si dhe të bëhet dokumentimi dhe monitorimi i incidenteve dhe problemeve nga DTI.

5.1 Rekomandimi: Strukturat drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të marrin masa për unifikimin e të dhënave për përdoruesit e Sistemit të Menaxhimit Elektronik të Gjobave, të plotësoj të dhënat që mungojnë për çdo përdorues, të ndërtojë kontrolle për mbylljen e tyre në kohën e duhur, të mbyllë përdoruesit të cilët kanë përfunduar objektin e

krijimit me qëllim ruajtjen e sistemit nga ndërhyrjet e paautorizuara, të marrë masa për rritjen e sigurisë së identifikimit të përdoruesit. Gjithashtu të marrë masa për analizimin e situatës aktuale të evidentuar nga grupi i auditimit në lidhje me integritetin dhe plotësinë e të dhënave mbi përdoruesit e sistemit eGjoba.

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të marrë masa për dokumentimin e politikave të sigurisë për përdoruesit e sistemit si dhe detyrimet që nevojiten të aplikohen në fjalëkalimet e tyre.

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, Njësia e Prokurimit, si dhe personat e autorizuar për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriteret kualifikuese të veçanta, të respektojnë legjislacionin dhe udhëzimet përkatëse në fushën e prokurimit publik duke mos vendosur kriteret të veçanta të panevojshme, për të garantuar një pjesëmarrje të gjerë dhe jo diskriminuese të operatorëve ekonomikë.

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, Njësia e Prokurimit, si dhe Specialisti i fushës të marrin masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të kryhet argumentimi ligjor dhe teknik i të gjitha kriterëve të vendosura, me qëllim nxitjen e konkurrencës së lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese ndaj operatorëve ekonomikë.

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, si dhe personat e autorizuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës, të marrin masa që për procedurat e prokurimit publik që do të zhvillohen në vijimësi të mbajnë parasysh të gjitha përcaktimet e dispozitave ligjore proceduriale përkatëse, duke mbikëqyrur rigorozisht zbatimin e kontratës për ofrimin e një malli apo shërbimi.

10.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues i shërbimeve të informatizuara në sistemin eGjoba, të përcaktojë si ndjekës të kontratës aktuale nr. 20, datë 16.08.2022 për këtë sistem, specialist të Drejtorisë së Policisë Rrugore që njohin proceset e punës dhe monitorojnë proceset e informatizuara në nivel qendror.

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues i shërbimeve të informatizuara në sistemin eGjoba, në mungesë të punonjësve që kanë vepruar si ndjekës të kontratave të sistemit eGjoba, të ngrejë një grup specialistësh me qëllim verifikimin e çështjeve që nuk janë realizuar në kontratën e parë nga OE, i cili është aktualisht i kontraktuar dhe për kontratën aktuale. Mangësitë të përcillen tek AKSHI si Autoritet Kontraktues për sistemin eGjoba dhe përmirësimin e tij.

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues i shërbimeve të informatizuara në sistemin eGjoba, të përcjellë tek AKSHI si Autoritet Kontraktues, mangësitë në zbatimin e kontratës për përmirësimin e sistemit eGjoba në zbatim të kontratës nr.20, datë 16.08.2022, të cilat jo vetëm nuk janë realizuar, por kanë penguar veprimet operationale të nevojshme për Drejtorinë e Policisë Rrugore Drejtorisë së Policisë Rrugore.

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si institucion krijues dhe administrues i të dhënave që ruhen në sistemin eGjoba, të marrë masa për hartimin e procedurave, organizimin dhe funksionimin e brendshëm si dhe përcaktimin e niveleve të aksesimit në këto të dhëna, në zbatim të nenit 5 të ligjit nr.10325, datë 23.09.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

14.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me Drejtorinë e Policisë Rrugore të marrin masa për unifikimin e të dhënave të ndryshme të evidentuara në procesverbalet që gjenerohen nga i njëjti sistem, por nga ndërfaqe përdorimi të ndryshme që gjenerohen nga agjentët nëpërmjet pajisjeve tablet dhe ndërfaqja në përdorim të zyrës operationale.

15.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të përcjellë për zgjidhje tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit problematikat që janë evidentuar nga auditimi dhe vijnë si rezultat i mangësisë apo parregullsisë së ndërtuar si ndërveprim ndërmjet

bazë së të dhënave të sistemit eGjoba dhe bazës së të dhënave të mjeteve nën administrimin e DPSHTRR-s.

16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit/ Drejtoria e Policisë Rrugore të marrë masa për të shmangur veprime manuale joefektive të agjentëve të policisë rrugore për të dhëna që gjenden të regjistruara në sistemin eGjoba. Gjithashtu, të merren masa për pajisjen e tyre me elementët e nevojshëm si letër printeri, bateri, etj për përdorimin e pajisjeve regjistruese të kundravajtjeve në terren me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes dhe veprimet në sistem.

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues për shërbimet e informatizuara në sistemin eGjoba, të përcjellë tek AKSHI procesin që nuk është realizuar nga OE për mundësimin e regjistrimit të të dhënave të kundravajtjes në sistemin eGjoba në mënyrë që këto të dhëna të jenë të ekspozueshme për sistemin TIMS.

17.2 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit si Autoritet Përfitues për shërbimet e informatizuara në sistemin eGjoba, të përcjellë tek AKSHI, nevojën për të regjistruar në sistem arkëtimin e vlerës së kundravajtjes së kryer nga mjete me targa të huaja, si në një proces që aktualisht ka mbetur jashtë informatizimit dhe administrohet manualisht në bllok fizik nga agjenti.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI “PËR AUDITIMIN E ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE TË LËNA NË GJASHTË MUJORIN E PARË TË VITIT 2024,
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
“PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË VITIN 2024
(GJASHTË MUJORI I PARË)”**

“SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR”

Tiranë, Korrik 2025

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE	3
II.	HYRJA	4
1.	Objekti	4
2.	Qëllimi	4
3.	Metodologjia	4
4.	Konkluzioni	4
III.	OPINIONI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE	4
IV.	ZBATIMI I REKOMANDIMEVE	5-13

I. PËRMBLEDHJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e në vazhdim KLSH*), ushtri auditimin në Shërbimin Social Shtetëror (SHSSH), mbi “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara në 6-mujorin e parë të vitit 2024” me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit” të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1137/10 prot., datë 05.06.2024, miratuar me Vendimin nr. 1138/9 prot., datë 04.06.2024, të Kryetarit të KLSH-së, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH^{së} të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2024, hartimin e programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si:
 - a. vendimet (urdhrat) për zbatimin e masave organizative;
 - b. vendimet ekzekutive për shpërblimin e dëmit;
 - c. vendimet ekzekutive për përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve;
 - ç. vendimet e nëpunësit autorizues, komisioneve disiplinore për dhënien e masave disiplinore e të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në përfundim të procesit të auditimit, rezulton se:

I.1. Respektimi i afatit ligjor 20 ditor, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

- SHSSH, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ka respektuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, duke përcjellë shkresën nr. 4409/2 prot., datë 26.06.2024 “Zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” protokolluar në KLSH me nr. 1138/12 prot., datë 27.06.2024.

I.2. Respektimi i afatit ligjor 6 mujor, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

- SHSSH, nuk ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

I.3. Rekomandimet e KLSH

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse nr. 1137/10 prot., datë 05.06.2024, janë lënë **15** masa organizative gjithsej.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga **15** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **9** janë zbatuar plotësisht, **4** janë në proces zbatimi dhe **2** nuk janë zbatuar.

I.4. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve të KLSH

- SHSSH, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ka pranuar rekomandimet dhe ka angazhuar strukturat përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve. Statusi i pranueshmërisë së rekomandimeve nga SHSSH, është si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Të rekomanduara nga KLSH	Të pranuar nga SHSSH
1	Masa organizative	15	15
	Gjithsej	15	15

I.5. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga SHSSH

Në mënyrë të përmbledhur statusi i rekomandimeve të pranuar paraqitet si më poshtë:

Nr.	Lloji i rekomandimit	Pranuar	Statusi i zbatimit		
			Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces
1	Organizative	15	9	2	4
	Gjithsej	15	9	2	4

II. HYRJE

Auditimi u krye në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve”.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, sipas drejtimeve të Programit të Auditimit nr. 366/3, datë 25.03.2025, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer nga Grupi i Audituesve Shtetëror të KLSH, i përbërë nga:

- A.K, përgjegjëse grupi
- K.S, anëtare
- B.A, anëtar
- A.A, anëtar

II.1. OBJEKTI AUDITIMIT

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara me shkresën e KLSH-së, nr. 1137/10 prot., datë 05.06.2024, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

II.2. QËLLIMI AUDITIMIT

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II.3. METODOLOGJIA E AUDITIMIT

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen.

II.4. KONKLUZIONI

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë **15** masa organizative.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Nga **15** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **9** janë zbatuar plotësisht, **4** masa janë në proces dhe **2** masa nuk janë zbatuar.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces
Masa Organizative	15	9	2	4
Total	15	9	2	4

III. OPINION I PËRGJITHSHËM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE

- SHSSH, nuk ka respektuar afatin 6 - mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

- SHSSH ka pranuar rekomandimet e lëna nga KLSH, ka vepruar dhe marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve.

- Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 60%.

IV. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve në SHSSH, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën nr. 1137/10 prot., datë 05.06.2024, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për auditimin “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit” në Shërbimin Social Shtetëror;
- Dokumentacionin shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve, etj.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe manualin “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacioni që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH”. Nga auditimi i ushtruar në SHSSH, për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të teknologjisë së informacionit të KLSH, me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit” në Shërbimin Social Shtetëror, të pasqyruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 1138/9 prot., datë 04.06.2024, të Kryetarit të KLSH-së të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1137/10 prot., datë 05.06.2024, konstatohet se:

- SHSSH, **ka respektuar** afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

- SHSSH, **nuk ka respektuar** afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, në zbatim të neni 30, pika 2 të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Për sa më lart, strukturat përgjegjëse pranë SHSSH, nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor të përcaktuar në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” nenin 30, pika 2, duke mos përcjell pranë KLSH planin e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar për auditimin e teknologjisë së informacionit “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit” për përcjelljen brenda afateve kohore progresin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në Raportin Përfundimtar të auditimit nr. 1137/10 prot., datë 05.06.2024, “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit” në Shërbimin Social Shtetëror, ka rekomanduar 15 (pesëmbëdhjetë) masa organizative.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se niveli i zbatimit të rekomandimeve nga SHSSH, është si më poshtë:

Nga **15** masa organizative të rekomanduara, janë zbatuar **9** prej tyre.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se struktura TI e SHSSH ende nuk ka kaluar si pjesë e strukturës së AKSHI-t sipas përcaktimeve dhe afateve të vendosura në VKM Nr. 673, datë 22.11.2017, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

1.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të Shërbimit Social Shtetëror të analizojnë dhe vlerësojnë situatën për marrjen e masave për kalimin e strukturave përgjegjëse TIK tek AKSHI në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Shërbimi Social Shtetëror ka dërguar shkresën nr. 3848 prot., datë 16.05.2024 drejtuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe për dijeni Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për kalimin e strukturës TI pranë tyre.

Komenti i grupit të auditimit: Shërbimi Social Shtetëror me shkresën nr.3848 prot., datë 16.05.2024 i është drejtuar AKSHI-t që struktura e specialistëve TI të SHSSH të kaloj pjesë e strukturave të AKSHI-t.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se nuk ka propozime konkrete nga niveli menaxherial i SHSSH për zhvillimin e trajnimeve dhe se nuk është i dokumentuar procesi i kërkesave, nevojave dhe analizimi i tyre për kualifikime profesionale, duke mos plotësuar kështu nevojat për trajnim mbi sistemet, sigurinë dhe teknologjinë e informacionit.

- Në Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Shkodër dhe Vlorë u konstatua se specialistët e TI në këto drejtori nuk kanë kryer trajnime profesionale brenda dhe jashtë vendit të cilat do ti shërbenin stafit për kualifikime të mëtejshme për ti ndihmuar në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në përkrahjet e tyre të punës.

2.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror të marrë masa për identifikimin e nevojave për trajnime profesionale teknike të punonjësve të Teknologjisë së Informacionit, si një mënyrë që nxit dhe përmirëson kryerjen e detyrave me nivel të lartë profesional.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Specialistët IT kanë ndjekur dhe do të vazhdojnë të ndjekin trajnime të planifikuara nga Shkolla Shqipëtare e Administratës Publike (ASP) për të përmirësuar kryerjen e detyrave me nivel të lartë profesional.

Komenti i grupit të auditimit: Specialistët IT kanë ndjekur dhe po vazhdojnë të ndjekin trajnime të planifikuara nga SHSSH.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Teknologjia e Informacionit në SHSSH zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregullatore. SHSSH nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe praktikat më të mira, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion; rregulla mbi menaxhimin e incidenteve; procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet/ incidentet e ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre; struktura kontrolli për verifikimin e efektivitetit të ndryshimeve të kryera; procedura për ndryshimet emergjente si dhe dokumentimin e të gjithë procesit të ndryshimeve. Mungesa e bazës së brendshme rregullatore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit sjell operimin mbi baza ngjarjeje dhe jo sipas procedurave të përcaktuara, duke rritur riskun e ekspozimit të institucionit ndaj situatave ku reagimi është i paidentifikuar, burimet njerëzore dhe përgjegjësitë të paalokuara, si dhe koha e përgjigjes e papërcaktuar.

3.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror të marrë masa për hartimin e një Rregulloreje të Përgjithshme mbi Teknologjinë e Informacionit duke marrë në konsideratë vendosjen e kontroleve të brendshme lidhur me menaxhimin e riskut, përputhshmërinë me procedurat dhe rregullat e brendshme aktuale të shoqërisë si dhe me legjislacionin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Shqipëri.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Ngjitja e një grupi pune me anëtarë nga të dy insitucionet (MSHMS dhe SHSSH), për hartimin e një Rregulloreje të Përgjithshme mbi Teknologjinë e Informacionit.

Komenti i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 335, datë 22.10.2024 është ngritur grupi i punës për hartimin e treguesve kryesor të riskut dhe ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore në fuqi.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Shërbimi Social Shtetëror nuk ka hartuar regjistër risku lidhur me teknologjinë e informacionit dhe se nuk janë dokumentuar risqet e identifikuar për periudhën objekt auditimi, si rreziku i biznesit që lidhet me përdorimin, pronësinë, operimin, përfshirjen, ndikimin dhe adoptimin e TI në SHSSH.

4.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror të marrë masa për identifikimin dhe analizimin e risqeve për Teknologjinë e Informacionit me qëllim analizimin dhe vlerësimin e risqeve dhe përmbushjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: - Ngritja e një grupi pune për hartimin e treguesve kryesor të riskut të Sistemeve Elektronike, “Urdhër nr.335, shkresa nr. 8053 prot., datë 22.10.2024”.

- Hartimi i treguesit kryesor të riskut për sistemet e Ndihmës Ekonomike, Aftësisë së Kufizuar dhe Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror. (Shkresë Përcjellëse nr.8657 datë 11.11.2024).

Komenti i grupit të auditimit: Shërbimi Social Shtetëror ka marrë masa për identifikimin dhe analizimin e risqeve për Teknologjinë e Informacionit.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Sektori i Auditit të Brendshëm në SHSSH për periudhën 01.01.2021-31.12.2023 nuk ka kryer asnjë auditim mbi sistemet e teknologjisë së informacionit, në kundërshtim Ligjin nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin publik” nenit 4, pika 6, nenit 9 dhe Standardeve ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar për t’u zbatuar në Republikën e Shqipërisë.

5.1 Rekomandimi: Sektori i Auditit të Brendshëm të marrë masa mbi planifikimin dhe kryerjen e auditimeve mbi teknologjinë e informacionit, me qëllim vlerësimin e kontrolleve të menaxhimit në infrastrukturën e TI, në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe operimin në mënyrë efektive mbi arritjen e objektivave të institucionit.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit me shkresën nr. 366/6 prot., datë 24.04.2025: SHSSH ka dërguar në KLSH shkresën nr. 2651/3 prot., datë 18.04.2025 për gatishmërinë që AKSHI ka treguar për të mbështetur grupin e auditimit të SHSSH me një përfaqësues nga AKSHI për kryerjen e auditimit të teknologjisë së Informacionit.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ndjekësit e kontratave të nivelit të shërbimit nuk mbajnë një procesverbal për të konfirmuar veprimet e kryera në sistem të cilat janë të pasqyruara në raportet mujore të sjella nga kontraktuesi të renditura si më poshtë:

-Kontroll i Gjendjes së Failover Cluster;

-Kontroll i Gjendjes së Failover Cluster Sql Te Serverave;

-Raportim i Sistemit të Backup;

-Probleme të Verifikuara gjatë Kontrolleve Periodike të Shërbimeve Infrastrukturore.

6.1 Rekomandimi: Komisioni i marrjes në dorëzim në MSHMS të marrë masa që në të ardhmen të mbajë raporte periodike mbi zbatimin e kontratës, në përputhje me kushtet e veçanta të kontratës si dhe me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: Komisioni i ngritur me urdhrin e Titullarit të Autoritetit Kontraktor për mbikëqyrjen e kontratës ka mbajtur procesverbale çdo muaj, pas kontrollit dhe verifikimit të shërbimeve të mirëmbajtjes mujore të paraqitura nga kontraktori nëpërmjet raporteve periodike mujore dhe është marrë në dorëzim shërbimi në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës. Në vijim të rekomandimit të lënë është proceduar me njoftim të ndjekësve të kontratave dhe përditësim të procesverbalit në përputhje me elementet e kërkuarë.

Komenti i grupit të auditimit: Komisioni ka mbajtur procesverbale pas kontrollit dhe verifikimit të shërbimeve të mirëmbajtjes mujore të paraqitura nga kontraktori nëpërmjet raporteve periodike mujore dhe është marrë në dorëzim shërbimi në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Infrastrukturës TIK dhe Sigurisë së Informacionit në Drejtorinë qendrore dhe Rajonale të SHSSH Vlorë, Shkodër u konstatua se:

- Në Drejtorinë rajonale të SHSSH (Vlorë, Shkodër) Infrastruktura Network e pajisjeve ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave është në kushtet jo optimale, ku shërbimet e ngritura mbi këto rrjete nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës.

- Në Drejtorinë Rajonale (Vlorë, Shkodër) nuk ka një linjë back up interneti në rast të shkëputjes së linjës, duke sjellë kështu mosfunksionim të sistemit dhe ndërprerje të ofrimit të shërbimeve. Kompjuterat nuk janë të pajisur me antivirus për mbrojtje ndaj sulmeve. Nuk ka një server qendror të pajisur me Domain Controller për menaxhimin e përdoruesve dhe vendosjen e politikave të sigurisë. Nuk kanë një pajisje firewall për mbrojtjen e rrjetit nga sulmet e jashtme.

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror ka një ambient në të cilën ruhen pajisjet e rrjetit si modema me fibër optike dhe switch layer 3 por ambienti fizik i ruajtjes së pajisjeve të rrjetit nuk plotëson kushtet minimale të sigurisë, si: ftohja, lagështira e ajrit, sistemi elektrik, dera e aksesit në ambient.

- Në Infrastrukturën network të SHSSH të gjithë përdoruesit mund të shohin listën e printerave dhe kompjuterëve në lidhjen LAN, që tregon një mungesë të segmentimit të rrjetit ose kontrolleve të aksesit. Kjo ekspozon burimet e ndjeshme të rrjetit ndaj përdoruesve të paautorizuar dhe rrit rrezikun e aksesit të paautorizuar, shkeljeve të të dhënave dhe aktivitetit keqdashës.

7.1 Rekomandimi: SHSSH të marrë masa për pajisjen dhe standardizimin e infrastrukturës IT në Drejtorinë e saj si dhe të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një procedure standarde për komunikimin dhe zgjidhjen e problematikave që lindin me Drejtorinë Vendore në lidhje me sigurinë e IT, me qëllim sigurimin e kushteve optimale për ofrimin e shërbimit dhe mbarëvajtjen e punës pa ndërprerje.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Për problematikën në lidhje me sistemet, IT qendror të SHSSH dhe 12 IT në Drejtorinë Rajonale, praktika e unifikuar raportohen në CRM (ku më pas mirëmbajtësi i sistemit vazhdon procedurën për zgjidhjen e problemit) si dhe komunikim me email me personat përgjegjës për çdo rast të adresuar. Kjo praktikë do të përfshihet në rregulloren që do të hartohet. SHSSH ka marrë masa që Drejtorinë Rajonale të pajisin kompjuterat me antivirus.

Komenti i grupit të auditimit: SHSSH ka marrë masa për hartimin dhe miratimin e një procedure standarde për komunikimin dhe zgjidhjen e problematikave që lindin me Drejtoritë Vendore në lidhje me sigurinë e IT.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se kontraktuesit nuk i është caktuar niveli i aksesit nga Institucioni përfitues dhe shfrytëzues i sistemit për aksesimin e të dhënave. Hapat që ndiqen për kryerjen e backup-it kryhen sipas politikave të kontraktuesit në kundërshtim me Udhëzimin nr.1 dt.31.07.2023 “Për zbatimin e dokumentit të përditësuar të politikave të vazhdimësisë së punës dhe planit për ruajtjen e informacionit” të AKSHI-t.

8.1 Rekomandimi: SHSSH si institucion zotërues i të dhënave të sistemeve NE, PAK, SHKSH në bashkëpunim me AKSHIN në kontratat e ardhshme të mirëmbajtjes së sistemeve duhet të përcaktojë nivelet e aksesit të Kontraktuesit në sisteme.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Aktualisht kryhet backup për sistemet dy herë në ditë.

Komenti i grupit të auditimit: SHSSH si institucion zotërues i të dhënave të sistemeve NE, PAK, SHKSH në bashkëpunim me AKSHI-n ka përcaktuar hapat që ndiqen për kryerjen e backup-it.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se AKSHI nuk ka ofruar një infrastrukturë BCC (Business Continuity Center) për SHSSH, në kundërshtim VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

9.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me AKSHI-n, bazuar në rëndësinë që ka ofrimi i shërbimit pas një fatkeqësie, të ndërmarrin hapat e nevojshëm për ndërtimin e një qendre *Business Continuity*.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Ashtu siç është sqaruar edhe në përgjigjet e dërguara nga AKSHI, për sa i përket politikave të vazhdueshmërisë së punës dhe rikuperimit nga katastrofat, nga ana e AKSHI-t, në zbatim të përcaktimeve ligjore të parashikuara në Ligjin nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, është miratuar Udhëzimi nr.1 datë 31.07.2023 “Për Zbatimin e Dokumentit të Përditësuar të Politikave të Vazhdimësisë së Punës dhe Planit për Ruajtjen e Informacionit”, i cili i është vënë në dispozicion dhe grupit të auditimit. Ky qëndërim përfshin të gjithë komponentët ku një ndër të cilët është dhe vazhdimësia e punës. Në këto kushte vlerësojmë se rekomandimi për të ngritur një qendër BCC vetëm për shërbimet e SHSSH do të ishte një rast përjashtimor dhe do të sillte një kosto të lartë për buxhetin.

Komenti i grupit të auditimit: AKSHI bazuar në rëndësinë që ka ofrimi i shërbimit është duke qëndërzuar infrastrukturën.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Shërbimi Social Shtetëror nuk disponon përdoruesin me të drejta të plota – Db Owner, megjithëse është përgjegjëse për të dhënat që popullojnë sistemet e Ndihmës Sociale. Ky user ka kontroll të plotë mbi një bazë të dhënash, që do të thotë ka aftësinë për të krijuar, modifikuar dhe fshirë objekte brenda bazës së të dhënave.

10.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror si institucioni përgjegjës i bazës së të dhënave të sistemeve e Ndihmës Sociale, të marrë masat për menaxhimin e bazës së të dhënave, që përmban të gjitha llojet e aksesit në sistemet që ka në përdorim.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Me strukturën aktuale të SHSSH, është e vështirë të merret në dorëzim baza e të dhënave për 3 sistemet (NE, PAK, SHSSH). Në varësi të vendimit që do të merret për kalimin e IT pranë AKSHI-t, do të procedohet me këtë rekomandim.

Komenti i grupit të auditimit: Shërbimi Social Shtetëror si institucioni përgjegjës i bazës së të dhënave të sistemeve të Ndihmës Sociale, nuk ka marrë masat për menaxhimin e bazës së të dhënave, që përmban të gjitha llojet e aksesit në sistemet që ka në përdorim.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përdoruesve të sistemeve të SHSSH u konstatua se:

- Detyra e administratorit të sistemit në rolin e Administratorit të SHSSH nuk është e caktuar me anë të një shkrese zyrtare nga organet drejtuese të MSHMC dhe AKSHI në mënyrë që të përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrat e administratorit të sistemit. Nuk disponohet një akt rregullativ i dokumentuar dhe i miratuar për administrimin/menaxhimin e përdoruesve, në të cilën të jenë të përcaktuara procedurat që do të ndiqen për krijimin, fshirjen, ndryshimin.

-Nga auditimi i përdoruesve të sistemeve (NE, PAK, SHKSH) u konstatua se ka përdorues aktiv me emër useri të pa Identifikuar.

-Nga auditimi i përdoruesve të databasës u konstatua se ekzistojnë një numër përdoruesish por nuk është kryer një ndarje privilegjesh për çdo përdorues sipas niveleve në bazë të detyrave që ata kanë.

11.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me AKSHI-n të marrin masa për administrimin e përdoruesve të brendshëm, ku të përcaktohen saktë lidhja e punonjës-user në sistem sipas detyrave të caktuara që ata kanë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Në zbatim të Ligjit nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike” për AKSHI-n, AKSHI ka hartuar dhe miratuar Rregulloren e Sigurisë së Informacionit nr. 2, datë 06.11.2023 “Për sigurinë e Informacionit” ku cilësohen dhe përcaktohen të gjithë elementet që citohen nga grupi i auditimit. Gjithashtu për sa i përket procesit të krijimit të përdoruesve të sistemit, procesi realizohet nga Shërbimi Social Shtetëror. Ndërkohë për çdo krijim apo mbyllje të aksesit në Active Directory (logim me SSO nga AD) dhe VPN bëhet rast pas rasti vetëm me kërkesë të SHSSH-së. SHSSH ka marrë masa që përdoruesit që nuk janë më në detyrë janë çaktivizuar dhe kjo do jetë pjesë e procedurës në vijimësi.

Komenti i grupit të auditimit: Shërbimi Social Shtetëror në bashkëpunim me AKSHI-n ka marrë masat për administrimin e përdoruesve të brendshëm.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se SHSSH nuk ka hartuar akte rregullatore për menaxhimin e log-eve digjitale ku specifikohen kërkesat për ruajtjen e log-eve përkatëse për çdo sistem/pajisje të institucionit, procedurat e administrimit dhe përgjegjësitë, në kundërshtim me pikën 4 shkronja a) të “*Rregullores për menaxhimin e log-eve digjitale në Administratën Publike*”, miratuar me urdhrin nr. 109 datë 10.06.2016 të Drejtorit të Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).

12.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrin masa për rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave duke hartuar një procedure apo rregullore për menaxhimin e gjurmës elektronike të auditimit, me qëllim uljen e riskut mbi sigurinë e të dhënave me pasojë humbjen dhe tjetërsimin e tyre. Gjithashtu, në këtë dokument duhet të specifikohet qartë vendi ku ruhen gjurmët, për cilat veprime të përdoruesit ruhen këto gjurmë, koha, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe

analizimin e tyre, detyrat dhe përgjegjësitë, e çdo element tjetër që i shërben sigurisë së të dhënave dhe parandalimit në tjetërsimin e tyre.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Procedura e cila kryhet aktualisht do të jetë pjesë e rregullores: Logimi në të 3 sistemet e SHSSH bëhet nëpërmjet VPN. Çdo përdorues ka kredencialet e tij në VPN. Përveç kredencialeve, në momentin që përdoruesi bën connect VPN, në mailboxin zyrtar vjen një kod 6 shifror, vendoset kodi 6 shifror dhe më pas VPN bëhet connect. Ndërsa për mailboxin zyrtar përveç passwordit që përdoruesit kanë vendosur, janë të pajisur edhe me Microsoft Authenticator. Nga ana e AKSHI në vijim të rekomandimit është vijuar me kërkesë ndaj Kontraktuesve të kontratave të sistemeve respektive, që të kryejnë përditësimin e manualeve përkatëse të përdorimit.

Komenti i grupit të auditimit: Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, kanë marrë masa për rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, sistemet e Ndhmës Ekonomike nuk ndërveprojnë me Webservice me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës. Mungesa e ndërveprimit ndërmjet sistemeve sjell riskun e vlerësimit të gabuar të aplikantëve për Ndhmën Ekonomike. Sistemi nuk mund të verifikoj nëse aplikantët kanë ose jo prona të regjistruara në ASHK.

13.1 Rekomandimi: AKSHI dhe Shërbimi Social Shtetëror të marrin masa duke komunikuar me ASHK për gjetjen e problematikave të funksionimit të webservisit për të vendosur në funksionim të plotë ndërveprimin ndërmjet sistemeve që SHSSH dhe ASHK me qëllim rritjen e efikasitetit të vlerësimit të formularëve për aplikuesit e Ndhmës Ekonomike.

Menjëherë

Përgjigja e institucionit: SHSSH ka pasur komunikime të vazhdueshme në lidhje me komunikimin me sistemin e Kadastrës, por përgjigja e kthyer nga ana e tyre është që ASHK i ofron shërbimet e saj kundrejt tarifimit. Praktikisht pagesa është e pamundur të mbulohet nga buxheti i SHSSH. Shkresa nr. 848 prot., datë 29.06.2020.

Komenti i grupit të auditimit: Sipas shkresës së AKSHI-t nr. 1502/7, datë 25.06.2024, kthim përgjigje për masat e marra nga AKSHI për zbatimin e rekomanimeve të lëna nga KLSH, evidentohet se, Shërbimi Social Shtetëror nuk i ka bërë kërkesë ASHK-së për të adresuar ndërveprimin ndërmjet sistemeve të SHSSH dhe ASHK.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i pa zbatuar**.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përdorimit të funksionaliteteve të Sistemeve të SHSSH u konstatua se:

- Përdoruesit e Sistemeve të Shërbimit Social Shtetëror nuk mund të gjenerojnë dhe eksportojnë raporte.

- Sistemet kanë të aktivizuar Copy protection, përdoruesit nuk mund të kopjojnë dot tekstin që u nevojitet nga sistemi duke vonuar përpunimin e informacionit gjatë punës së tyre.

14.1 Rekomandimi: AKSHI në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror të analizojnë kërkesat e përdoruesve të sistemeve dhe të kryejnë ndryshimet e nevojshme për lehtësimin e punës në sistem pa çënuar sigurinë e sistemeve.

Në vijimësi

Përgjigja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim aktualisht në sistemet e Ndhmës Ekonomike, Pagesës së Aftësisë së Kufizuar dhe Regjistrimit të Shërbimeve Sociale ka raporte të

zhvilluara sipas kërkesave të përdoruesve. Këto raporte përditësohen sipas kërkesave të përdoruesve të sistemeve. Për arsye sigurie është bllokuar vetëm shkarkimi i raporteve në formatin excel. Gjithashtu, aktivizimi i opsionit Copy Protection është bërë në kuadër të rritjes së sigurisë dhe eliminimit të risqeve dhe problematikave.

Komenti i grupit të auditimit: AKSHI në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror kanë analizuar kërkesat e përdoruesve të sistemeve.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **i zbatuar**.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi aktet rregullatore të manualeve të përdorimit të sistemit u konstatua se Manualet e përdorimit të sistemeve të ndihmës Sociale nuk janë të përditësuara me ndryshimet e ndodhura në sisteme. Këto manuale shërbejnë si udhëzues për të gjithë përdoruesit që kanë të drejtë të aksesojnë sistemin.

15.1 Rekomandimi: AKSHI në bashkëpunim me OE që ofron shërbimin e mirëmbajtjes për këtë sistem, të hartojë, përditësojë dhe miratojë, manualin e përdorimit të sistemeve të Ndihmës Sociale duke reflektuar ndryshimet ndërfaqësore, funksionalitetin e sistemit që janë shtuar, rolet dhe përgjegjësitë që kanë pësuar ndryshime, mënyra e aksesimit dhe çdo ndryshim tjetër të ndodhur ndër vite në sistem.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigja e institucionit: AKSHI i ka kërkuar Kontraktuesit që ofron shërbimin e mirëmbajtjes të sistemeve të Ndihmës Sociale, përditësimin e manualeve të përdoruesve dhe përditësimin periodik të tyre pas çdo lloji ndryshimi.

Komenti i grupit të auditimit: AKSHI i ka bërë kërkesë OE që ofron shërbimin e mirëmbajtjes për këtë sistem që të hartojë, përditësojë dhe miratojë manualin e përdorimit të sistemeve të Ndihmës Sociale.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet **i pranuar** nga subjekti dhe **në proces zbatimi**.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Në proces
Masa Organizative	15	9	2	4
Total	15	9	2	4

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

- SHSSH, ka respektuar afatin 20 ditore të kthimit të përgjigjes mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve për KLSH
- SHSSH, nuk ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve për KLSH
- SHSSH, ka vepruar dhe ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve.
- Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 60%.

Për sa më sipër, ri kërkojmë që, Shërbimi Social Shtetëror, të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim zbatimin e rekomandimeve që rezultojnë me statusin të pazbatuara dhe në proces zbatimi, brenda vitit 2025.

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Organet drejtuese të Shërbimit Social Shtetëror të analizojnë dhe vlerësojnë situatën për marrjen e masave për kalimin e strukturave përgjegjëse TIK tek AKSHI në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi.

5.1 Rekomandimi: Sektori i Auditit të Brendshëm të marrë masa mbi planifikimin dhe kryerjen e auditimeve mbi teknologjinë e informacionit, me qëllim vlerësimin e kontrolleve të menaxhimit në infrastrukturën e TI, në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave

dhe operimin në mënyrë efektive mbi arritjen e objektivave të institucionit.

9.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror, në bashkëpunim me AKSHI-n, bazuar në rëndësinë që ka ofrimi i shërbimit pas një fatkeqësie, të ndërmarrin hapat e nevojshëm për ndërtimin e një qendre *Business Continuity*.

10.1 Rekomandimi: Shërbimi Social Shtetëror si institucioni përgjegjës i bazës së të dhënave të sistemeve e Ndhmës Sociale, të marrë masat për menaxhimin e bazës së të dhënave, që përmban të gjitha llojet e aksesit në sistemet që ka në përdorim.

13.1 Rekomandimi: AKSHI dhe Shërbimi Social Shtetëror të marrin masa duke komunikuar me ASHK për gjetjen e problematikave të funksionimit të webservisit për të vendosur në funksionim të plotë ndërveprimin ndërmjet sistemeve që SHSSH dhe ASHK me qëllim rritjen e efikasitetit të vlerësimit të formularëve për aplikuesit e Ndhmës Ekonomike.

15.1 Rekomandimi: AKSHI në bashkëpunim me OE që ofron shërbimin e mirëmbajtjes për këtë sistem, të hartojë, përditësojë dhe miratojë, manualët e përdorimit të sistemeve të Ndhmës Sociale duke reflektuar ndryshimet ndërfaqësore, funksionalitet e sistemit që janë shtuar, rolet dhe përgjegjësitë që kanë pësuar ndryshime, mënyra e aksesimit dhe çdo ndryshim tjetër të ndodhur ndër vite në sistem.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT